REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 16/17, 18/17
Datë/Datum. 02. 02. 2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **Ministria e Infrastruktures**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - **OSHP** **Nr.16/17** **Nr.18/17**
Nga:	Basri Fazliu - Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën: **"Ndërtimi i rreth-rrotullimit të gjelber (Bulevardi i Gjelbër) në Rrugën Nacionale N9(hyrja e Pejës)",** me nr. prokurimi: **MI 16/082/511.**		
Përgjigjeje në ankesë:	**OE "Conex Group"sh.p.k-Prishtinë** **OE "Lika Trade" sh.p.k-Deçan**		
Datë	**02.02.2017**		

Bazuar në nenin 113.1 të LPP-së ju njoftojmë me ekspertizën e lëndës lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i rreth-rrotullimit të gjelber (Bulevardi i Gjelber) në Rrugen Nacionale N9 (hyrja e Pejës)"** me nr. prokurimi: **MI 16/082/511,** të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Ministria e Infrastruktures,** dhe me përgjigjeje ndaj ankesës së operatorit ekonomik: **"Conex Group" sh.p.k-Prishtinë dhe OE "Lika Trade" sh.p.k-Deçan,** me nr.prot.16-18/17, e datës 18 dhe 19.01.2017

Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa IX e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i pavarur, ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë.

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI MBI EKSPERTIZËN E EKSPERTIT SHQYRTUES:

		24.01.2017		26.01.2017		02.02.2017
Nënshkrimi i ekspertit		Data e pranimit të autorizimit		data e fillimit të ekspertizës		data e dorëzimit të raportit të ekspertizës

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit.

Me datë: 18 dhe 19 Janar 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën me numër të protokollit: 16-18/17, e parashtruar nga operatori ekonomik: "Conex Group"-sh.p.k-Prishtinë dhe OE "Lika Trade" sh.p.k, me seli në Deçan, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Ndërtimi i rreth-rrotullimit të gjelber (Bulevardi i Gjelber) në Rrugen Nacionale N9 (hyrja e Pejes)", me nr. prokurimi: MI 16/082/511, të iniciuar nga Autoriteti kontraktues (AK) – Ministria e Infrastruktures.
Konform nenit 113.1, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si më poshtë:

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues:* ***"Conex Group" sh.p.k-Prishtinë***

Pikat e Ankesës:
Neni 1.36. Tenderet e pa pergjegjshem

Tenderet të cilët nuk janë në përputhje me:

a) Dosjen e tenderit, duke përfshirë kërkesat teknike dhe kontraktuale

b) Kërkesat e legjislacionit përkatës

c) Nuk përmbushin kërkesat e autoritetit kontraktues siq janë specifikuar në dosjen e tenderit.

Duke marrë në konsideratë se ligji e përkufizon tenderin e papërgjegjshëm, kompania jonë ka ofruar një tender të përgjegjshëm në përputhje të plotë me dosjen e tenderit, me çka LPP, çdo here i referohet dosjës së tenderit si kusht themelor që duhet të plotësohet nga kompanitë. Ne kemi ofruar një tender të përgjeshëm dhe Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar Ligjin për t'na shpallur neve si fitues i këtij projekti, por shpallë një kompani të papërgjeshme si fituese të projektit në fjalë.

Janë cenuar dispozitat e **Nenit 59** Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i tendëreve.

Janë shkelur dipozitat e **Nenit 60** Kriterët për Dheniën e Kontratës, ku theksohet:

Autoriteti kontaktues duhet t'ja jap kontraten publike operatorit ekonomik qe ka dorezuar tenderin e përgjegjshem me cmimin me te ultë.

N. 111,-*Operatori Ekonomik Ankues:* ***"Lika trade"-sh.p.k-Deçan***

Pikat e Ankesës:

- Neni 1 Qëllimi
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi

- Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës
- Neni 27 dosja e tenderit.
- Neni 52 Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës
- Neni 65 Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve
- Neni 69 Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
- Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë
- Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet:

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet: OE Conex Group:
Letrën standarde për eleminim e kemi pranuar permes emailit me datën 28.12.2016 ku thuhet se kush do të shperblehet me kontratë, por ky vendimi që është marrë parasheh shkelje të nenit 59 pika 1 të LPP-së, ku shpallë fitues kompaninë Graniti sh.p.k.Nga qasja në Dokumentacion Operatori Ekonomik i shpallur fitues Graniti sh.p.k është i papërgjegjshëm i cili nuk i ka prezentuar dokumentet e poshtëshenuara konform kërkesave të "Dosjes së tenderit".Në vazhdim ju sjellim faktet dhe argumentet e marra sipas LPP-së nga Qasja në Dokumentacion për të gjitha pikat e poshtëshenuara te cilat i mungojnë Operatorit Ekonomik te shpallur fitues, Graniti Sh.p.k.

- **Çertifikata e regjistrimit të biznesit.**

Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk e ka te prezentuar në oferten e tij Çertifikaten e regjistrimit të biznesit ashtu siq kërkohet, por ka vetem fletën e parë të saj, ndërsa nuk e ka të bashkangjitur komplet Çertifikatën e biznesit me të gjitha informatat mbi biznesin siq është kërkuar gjë që e bënë të *pavleshëm si dokument zyrtar.*

- **Certifikata e TVSH-sé**

Operatori Ekonomik Graniti sh.p.k nuk e ka të prezentuar në ofertën e tij Çertifikatën e TVSH-së siq eshte kerkuar Kopje e noterizuar nga Noteri. Ku dokomenti i ofruar nuk eshte identik me origjinalin siq do te duhet te ishte dhe nuk do te duhej si ti tillë te Noterizohet nga Noteri pasi te cilit i mundon pjesa kryesore (e pasme) e dokumentit ku thuhet (udhëzim per perzonal te cilet posedojne çertifikate te TVSH-se) siq eshte kerkuar gjë që e bënë te pavleshëm si dokument zyrtar.

- **Çertifikata për Sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008**

Operatori Ekonomik Graniti sh.p.k nuk e ka të prezentuar në ofertën e tij Çertifikaten për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008 me numër SB. 14.0012.QMS, e leshuar nga CERTI W siq është kërkuar dhe siq do të duhej të ishte, pasi që i njejti ka bërë dorëzimin e kësaj Çertifikate të Noterizuar në Gjuhen Angleze, që me Ligjin për Noterinë e Republikës së Kosovës për t'a Noterizuar nje dokument do të duhej që së pari të përkthehet në njëren nga Gjuhet zyratre të aplikueshme në Republikën e Kosovës

- **Çertifikata për Sigurinë në Trafikun Rrugor ISO 39001:2012**

Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk e ka te prezentuar në oferten e tij Çertifikaten për sistemin e

Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008, me numer SB.16.0068.OTH, siq është kërkuar dhe siq do të duhej të ishte, pasi që i njejti ka bërë dorëzimin e kësaj Çertifikate të Noterizuar në Gjuhen Angleze, që me Ligjin për Noterinë e Republikës së Kosovës për t'a Noterizuar një dokument do të duhej që se pari të përkthehet në njëren nga Gjuhet zyratre të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

- **Raporti auditimit dhe i pasqyrave të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2013, 2014 dhe 2015)**

Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk i ka te prezentuar në oferten e tij Pasqyrat Financiare për vitin 2013 dhe 2015. Ka dorezuar disa fletë ku shifet qartë se nuk janë te meshkruara dhe vulosura pasqyrat financiare, përktësisht në faqën numer 5, gjë që e bënë të pavleshëm si Dokument. OE Graniti ka prezentuar siq duhet Pasqyrat financiare te Audituara për vitin 2014 në perputhje me Ligjin siq do të duhej të ishin edhe vitn 2013 dhe 2015. Ky dokument nuk e plotëson kërkesën e "Dosjes së Tenderit" pika 8.1 dhe 8.2 Qarkullimi i nga Pasqyrat Financiare nuk e mbulojnë kërkesën prej 4,000,000.00 e i cili duhet te hedhet poshte menjehere nga Komisioni i vleresimit.

Pika e FDT-së, 9.1 dhe 9.2 Kërkesa mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1-5

Kopjet e diplomave përkatëse, CV, Kontratat e punës me ofertuesin të noterizuara, dhe Referencat për stafin që do të jetë i angazhuar për këtë projekt. Për gjeodetin (kërkesa 3) duhet të ofrohet kopja e licencës e noterizuar.

- **Menaxher i projektit, Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë me 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).**

Operatori Ekonomik Graniti sh.p.k nuk e ka te prezentuar në oferten e tij Vendimin e Caktimit të Menaxherit të Projektit, nuk i ka të prezntuara referencat për punët e realizuara në Lëminë përkatëse siq është kërkuar për Menaxherin e Projektit Operatori Ekonimik ka prezentuar një kontratë pune të datës 20.11.2010 ku z.Ismet Loshi paraqitet në ketë kontratë si Drejtor i kompanisë dhe i njejti i bënë kontratë vetëvetës në cilësinë e Drejtorit (neni 5 i kontratës). Gjithashtu ka prezentuar të nenshkruar dhe vulosur nje Organogram të datës 03.08.2016, në të cilën shkruan 2.1 GRAFIKU I ORGANOGRAMIT (Këtu më poshtë paraqesim formën e organizimit të kompanisë "GRANIT", ku tregohen pozitat kryesore të përsonave kyq) që z.Ismet Loshi Shifet qartë se është Drejtor i kompanisë edhe në këtë procedurë të prokurimit dhe nuk e ka plotësuar kërkesen 9.1 dhe 9.2 te FDT-së per Menaxher te Projektit.

- **Udhëheqësi i punishtës**

Operatori Ekonomik Graniti sh.p.k ka të prezentuar në ofertën e tij z.Mustaf Ademaj si inxhinier të ndertimtarisë, diplomën e noterizuar me numer 12, mirëpo nuk ka prezentuar Vendimin e Caktimit të udhëheqësit të punishtës, nuk ka prezentuar Referencat për punet e kryera në lëminë perkatëse siq është kërkuar në FDT, pika 9.1 dhe 9.2. Ku nuk e plotëson as këtë kërkesë të "Dosjes së tenderit".

- **Gjeodeti**

Operatori Ekonomik Graniti sh.p.k ka të prezentuar në ofertën e tij z.Halit Kabashi si inxhinier i Gjeodezisë, diplomën e noterizuar me numër 68/83, mirëpo nuk ka prezentuar Referencat për punët e kryera në lëminë përkatëse siq është kërkuar në FDT, pika 9.1 dhe 9.2. Ku nuk e plotëson as këtë kërkesë të "Dosjes së tenderit".

- **Inxhinieri i Komunikacionit**

Operatori Ekonomik i Graniti sh.p.k ka të prezentuar në ofertën e tij z.Veton Gashi si inxhinier të

komunikacionit nuk ka prezentuar CV-inë dhe Referencat për punët e kryera në lëminë përkatëse siq është kërkuar në FDT, pika 9.1 dhe 9.2. OE Graniti shpk ka të prezntuar nje kontratë ndermjet palëve për këtë projekt me datë 01.08.2016, mirëpo ka edhe një CV të cilën e ka nënshkruar dhe vulosur OE Graniti shpk për projekte të realizuara nga në të kaluaren nga kompania e tij, ku nga Dokumentacioni i prezentuar (kontrata ndërmjet palëve për angazhim në këtë projekt) ky inxhinier nuk ka qenë pjesë e projeketeve siq i ka përshkruar OE Graniti sh.p.k, me këtë CV të përshtatur për nevojat ekompanisë i ka qitur në Lajthitje Autoritetin Kontraktues. Operatori Ekonomik Graniti shpk nuk e plotëson as këtë kërkesë të "Dosjes së tenderit".

- **Inxhinieri i Elektros**

Operatori Ekonomik Graniti sh.p.k ka të prezentuar në ofertën e tij z.Skender Rugova si inxhinier të Elektros, nuk ka prezentuar CV-inë dhe Referencat per punet e kryera në lëminë perkatese siq eshte kerkuar ne FDT, pika 9.1 dhe 9.2. OE Graniti shpk ka te prezntuar nje kontratë ndermjet palëve për këtë projekt me datë 01.08.2016, mirëpo ka edhe një CV të cilën e ka nënshkruar dhe vulosur OE Graniti shpk për projekte të realizuara nga në të kaluaren nga kompania e tij, ku nga Dokumentacioni i prezentuar (kontrata ndermjet paleve per angazhim ne kete projekt) ky inxhinier nuk ka qenë pjesë e projeketeve siq i ka përshkruar OE Graniti sh.p.k, me kete CV te pershtatur per nevojat e kompanise i ka qitur ne Lajthitje Autoritetin Kontraktues.Operatori Ekonomik Graniti shpk nuk e plotëson as kete kërkesë te "Dosjes së tenderit".

- **Planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar**

Operatori Ekonomik Graniti sh.p.k ka të prezentuar në ofertën e tij nje Propozim/Plan te Menaxhimit te trafikut në forme te një deklarate se sa nje Plani se çfarë pune do të realizohej dhe aspak një Plani të Menaxhimit të detajuar të Trafikut siq do të duhej të ishte dhe siq kërkohet në "Dosjen e tenderit", plan i cili do të duhej të përmbante skema të rrugës, shënja të komunikacionit, projekt të menaxhimit të trafikut te automjeteve që do të qarkullojnë gjatë punës, etj. Operatori Ekonomik Graniti shpk nuk e plotëson as kete kërkesë te "Dosjes së tenderit".

- **Plani dinamik i detalizuar (gantogrami sipas pozicioneve të paramasës).**

Operatori Ekonomik Graniti sh.p.k ka të prezentuar në ofertën e tij një dokument në formatin Excell dhe jo në Formatin e kerkuar "Gantogrami sipas pozicioneve te paramasës". Jemi te bindur se as ai vet nuk e di se çka ka dashur të thote dhe te prezentoj me ate dokument te prezntuar si Plan Dinamik i cili edhe vet e konfirmon ne fleten e fundit te nenshkruar dhe vulosur se (Plani Dinamik do ti dorezohet menagjert te projektit per miratim sipas kontratës), ku me deklaraten e tij deshmon se nuk ka ofruar Plan Dinamik dhe nuk e plotëson as këtë kërkesë te "Dosjes së tenderit". Operatori Ekonomik Graniti shpk nuk e plotëson as kete kërkesë te "Dosjes së tenderit"

Nga Ju si Drejtor i prokurimit, personi kompetent për shqyrtimin e vendimeve të Komisioneve te Vleresimit, Kerkojme qe ta anuloni Njoftimin per Dhenjen e kontrates, te formoni Komisioni profesional te Vleresimit dhe lenden ta ktheni ne RI-SHQYRTIM dhe ta shperblej me kontrate OE "CONEX Group sh.p.k."si ofertuesin e pergjegjshem me çmimin më të ulëti cili i plotesonte gjitha kriteret e kerkuar ne dosjen e tenderit.

Deklarata detale mbi faktet dhe argumentet: "Lika Trade" sh.p.k –Deçan:
Procedurat e udhehequra nga Autoriteti Kontraktues, ne lidhje me kete aktivitet te prokurimit per dhenien e kontrates OE"GRANIT" sh.p.k. ISTOG, i cili ne baze te dosjes se tenderit te Autoritetit Kontraktues eshte i papergjegjshem, prandaj Ri-vleresmi eshte bere ne kundershtim me Nenin 59 te LPP-se, per faktin se "Granit sh.p.k"- Istog nuk ploteson kushtet teknike dhe ligjore sipas FDT-se.

Operatori i rekomanduar per kontrat OE"Granit sh.p.k" nuk i ploteson kërkesat e dosjes se tenderit mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale te cilat kerkohen tek pika 9.1.2 dhe 9.1.

Operatori ekonomik "Granit"- Istog, i rekomanduar per kontrate nga ana e AK-M-se, nuk i ploteson kërkesat e dosjes se tenderit tek Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik pika 6.4.

Per te gjitha pretendimet tona ne kemi bere pershkrimin detal te tyre dhe kemi kerkuar nga Ak-ia qe te beje rishqyrtimin e vendimit per dhenie te kontrates duke marre per baze te gjitha pretendimet tona te cilat jane te pershkruara shume qarte dhe sakte ne Kerkesen per Rishqyrtim te cilen e kemi dorezuar prane AK-se.Me date 12.01.2017 permes email-it ne kemi pranuar vendimin mbi miratimin e kerkeses per rishqyrtim te OE"Lika Trade"-Deçan, si pieserisht te bazuar. Por nga brendia e vendimit I nieiti eshte ne kundershtim te plote me dispozitivin, titullin e tii, dhe arsyetimin e perfshire ne te. Eshte absurd fakti se ne njeren ane na aprovohet pjeserisht si e bazuar kerkesa per rishqyrtim, nderkaq ne anen tieter, AK-i MI- lene ne fuqi vendimin e tij me te gjitha ato shkelje te cilat tanime iane vertetuar ne formen e fakteve dhe shkresave, ku deshmohet se Operatori ekonomik Granit-Istog eshte i papergjegjshme dhe se dyshohet se ne dosja ka permbajtie te pavertete (falsifikuese).

Ne pjesen e arsyetimit te ketij refuzimi ne si OE nuk kemi marre fare pergjigje ne lidhje me pikat ankimore te parashtruara te cilat jane paraqitur shume qarte permes Kerkeses per Rishqyrtim drejtuar AK-se. Mendojme se mos trajtimi dhe anashkalimi i pretendimeve tona te paraqitura ne Kerkesen per Rishqyrtim, nga ana e M-se, eshte ne kundershtim me Nenit 108A pika12. Kjo aq me teper kur meret parasysh fakti se me daten 11.01.2017 ne MI, eshte dorezuar nje shkrese nga vet stafi i kompanise "Granit sh.p.k"-Istog, gjegjesisht nga Skender Rugova, ne te cilen shkrese, i njejti deklaron se iu jane keqperdore te drejtat e ti. dhe se i eshte falsifikuar CV-ja, me qellim qe OE "Granit sh.p.k" ta lajthite AK-ne MI-ne, ne dobi te marrjes se tenderit, gjegjesisht kontrates per projektin "Ndertimi i Rreth-Rrotullimit te gjelber ne Rrugen Nacionale N9 (Hyria e Pejes).

- **Shih Proven materiale: shkresa me nr. 04/103 e dates 11.01.2017 ku inxhinieri i paraqitur ne oferten "Granit"-Istog ka deklaruar se i eshte falsifikuar CV-ja per qellime te OE "Granit sh.p.k", nga ana e pronarit Ismet Loshi.**

Ne me tutje kemi pasur qasje ne oferten e OE "Granit" - Istog dhe kemi hasur ne keto te gjetura si ne vijim:

Nga letra standarde për eleminim, qe e kemi pranuar në e-mail zyrtarë me datën 29.12.2016, në të cilen është përcaktuar se kush do të shperblehet me kontratë, shihet se vendimi që është marrë, eshte ne kundershtim te plote me FDT-ne, dhe rredhimisht edhe ne shkelje te plote të nenit 59 pika I të LPP-së, ku shpallë fitues kompaninë Graniti sh.p.k, duke qene ne dijeni se e njejta eshte e papergjegjshme dhe ne kundershtim me LPP-ne.

Nga qasja në Dokumentacion e Operatorit Ekonomik te shpallur fitues Graniti sh.p.k- Istog, shihet se eshte operator ekonomik qe ka afruar çmim me te shtrenjte per rreth afer 30 mije euro, aq me teper i njejti, nuk i ka prezentuar dokumentet e kerkurara me FDT dhe njoftim per kontrate. Nga qasja ne dokumentacionin tenderues dhe oferten e OE"Granit" - Istog ne kemi keçyre keto dokumente:

Pranueshmeria ligjore sipas FDT-se.

- Çertifikata e regjistrimit të biznesit, e OE "Granit" - Istog nuk eshte ofruar e kompletuar ashtu siç eshte kerkuar me FDT
- Regjistrimi i TVSH.
- Çertifikata për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008
- Çertifikata për Sigurinë në Trafikun Rrugor ISO 39001: 2012.

- Raporti auditimit dhe i pasqyrave të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2013, 2014 dhe 2015)
- Pika e FDT-së, 9. 1 dhe 9.2
- Menaxher i projektit, Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë me 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy() projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).
- Udhëheqësi i punishtës, Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë me 2 vite përvojë pune pas diplomimit, si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve. Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.
- Gjeodeti, Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Gjeodet (shkolla e lartë), ose Bachelor i diplomuar i gjodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit. Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.
- Inxhinier i komunikacionit me 2 vite përvojë pune pas diplomimit, në lëmin e kërkuar
- Inxhinier i elektros me 2 vite përvojë pune pa diplomimit ose bachelor i diplomuar i elektros.
- Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit.
- Planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar.
- Plani dinamik i detalizuar (gantogrami sipas pozicioneve të paramasës).

Në vazhdim ju sjellim faktet dhe argumentet e marra ne qasje te ofertes, ku sipas LPP-së nga Qasja në Dokumentacion për të gjitha pikat e lartëshenuara një nga një paraqesim shqetesimin tone per mungesat e ketij operatori ekonomik (Granit-Istog), dhe faktin se si eshte cilesuar i pergjegjshem nga AK-MI.

- **Çertifikata e regjistrimit të biznesit.**

Operatori Ekonomik "Granit sh.p.k"- Istog, i shpallur fitues nuk e ka te prezentuar në oferten e tij Çertifikaten e regjistrimit të biznesit ashtu siq kërkohet ne formen komplete, por ka vetem fletën e parë të saj, ndërsa nuk e ka të bashkangjitur komplet Çertifikatën e biznesit me të gjitha informatat mbi biznesin (Informitatat mbi biznesin, veprimtaritë, filialet, pronarët) siq eshte kerkuar gjë që e bënë te pavleshëm si dokument zyrtar. Prandaj nje mungese e tille nuk ploteson pranueshmerine ligjore te FDT-se dhe LPP-se (Neni 59).

- **Çertifikata e TVSH-së**

Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk e ka te prezentuar në oferten e tij Çertifikaten e TVSH-së siç eshte kerkuar me FDT. respektivisht Kopje e noterizuar nga Noteri. Ku dokomenti i ofruar nuk eshte identik me origjinalin siç do te duhet te ishte dhe nuk do te duhej si ti tillë te Noterizohet nga Noteri, pasi te njejtit i mungon pjesa kryesore (e pasme) e dokumentit ku thuhet (Udhëzim per perzonat te cilet posedojne çertifikate te TVSH-se) siq eshte kerkuar, gjë që e bënë te pavleshëm si dokument zyrtar. Prandaj si rrjedhoje ky operator ekonomik edhe kete pike nuk e ka plotesuar sipas FDT-se.

- **Çertifikata për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008**

Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk e ka te prezentuar në oferten e tij Çertifikaten për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008 me numër SB. 14.00.12. QMS, e leshuar nga CERTI W siç është kërkuar dhe siç do të duhej të ishte, pasi që i njejti ka bërë dorëzimin e kësaj Çertifikate të Noterizuar ne Gjuhen Angleze, që me Ligjin për Noterinë e Republikës së Kosovës për t'a Noterizuar nje dokument do te duhej që së pari të përkthehet në njëren nga Gjuhet zyratre të aplikueshme në Republikën e Kosovës, nga perkthyesi i autorizuar dhe licencuar ne Republiken e Kosoves.

- **Çertifikata për Sigurinë në Trafikun Rrugor ISO 39001: 2012**

Operatori Ekonomik "Granit sh.p.k"- Istog, i shpallur fitues nuk e ka te prezentuar në oferten e tij Çertifikaten për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008, me numer SB. 16.0068.OTH siq është kërkuar dhe siq do të duhej të ishte, pasi që i njejti ka bërë dorëzimin e kësaj Çertifikate të Noterizuar në Gjuhen Angleze, që me Ligjin për Noterinë e Republikës së Kosovës për t'a Noterizuar një dokument do të duhej që se pari të përkthehet në njëren nga Gjuhet zyratre të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

- **Raporti auditimit dhe i pasqyrave të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2013, 2014 dhe 2015**

Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk i ka te prezentuar në oferten e tij Pasqyrat Financiare për vitin 2013 dhe 2015. Ka dorezuar disa fletë ku shihet qartë se nuk janë te neshkruara dhe vulosura pasqyrat financiare, përktësisht në faqen numer 5 as nga Drejtori i kompanisë dhe as nga Drejtori financiar gjë që e bënë të pavleshëm si pasqyra financiare. OE Graniti duke e ditur formen e prezentimit te Pasqyrave Finaciare te Audituara (pasi qe i njejti nuk i ka paraqitur Pasqyrat financiare te Audituara për vitin 2014 në perputhje me Ligjin). I njejti qëllimisht ka paraqitur pasqyra jo relae dhe jo valide për ta futur në Lajthitje Autoritetin Kontraktues si dhe OSHP-ne me ç'rast i njejti ka bërë me dyshim te bazuar Veprën Penale te Legalizimit te permbajtjes se pa vertetë, dhe falsifikimit te dokumentit, pasi qe ka vene ne qarkullim dokumentin ne oferte, qa ka pasur per qellim lajthitjen e personit zyrtar, per te ardhur deri tek shperblimi me tender. Veper kjo qe duhet "ex oficio" te lajmerohet nga organet publike. Se ka per qellin përfitimin direkt në menyrë të kundërligjshme. Ky dokument nuk e plotëson kërkesën e "Dosjes së Tenderit" dhe të "Njoftimit për Kontratë" pika 8.1 dhe 8.2 Qarkullimi i nga Pasqyrat Financiare nuk e mbulojnë kërkesën prej 4,000,000.00 €. Prandaj shtrohet pyetja se per ç'arsye, AK-MI shperblen kete kompani te papergjegjshme, ne deme te kompanise sone (Lika Trade), kur nga çmimi i ofruar shihet qe jemi me te lire per afër 30 mije euro, shtuar faktin se dokumentacioni jone tenderues nuk permban deklarata false, apo ndonje te dhene te pa vertete, per dallim nga OE"Granit"-Istog ku ka falsifikuar CV e stafit Kyç (inxh. Skender Rugova).

Me piken 9. 1 dhe 9.2 te FDT-së, tek Kërkesat mbi mundësinë teknike dhe/ose profesionale eshte kerkuar si ne vijim:

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1-5 Kopjet e diplomave përkatëse, CV. Kontratat e punës me ofertuesin të noterizuara, dhe referencat për stafin që do të jetë i angazhuar për këtë projekt. Për gjeodetin (kërkesa 3) duhet të ofrohet kopja e licencës e noterizuar.

- **Menaxher i projektit,** Inxhinier i dip. i ndërtimtarisë me 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi, ose ndërtimi i rrugëve).
- Operatori Ekonomik "Granit sh.p.k"- Istog, i shpallur fitues nuk e ka te prezentuar në oferten e tij Vendimin e Caktimit të Menaxherit të Projektit, nuk i ka të prezntuara referencat për punët e realizuara në Lëminë përkatëse. Pastaj Operatori Ekonimik " Granit"- Istog ka prezentuar një kontratë pune te datës 20.11.2010 ku z.Ismet Loshi paraqitet ne ketë kontratë si Drejtor i kompanisë dhe i njejti i bën kontratë vetë vetës ne cilësinë e Drejtorit (neni 5 i kontrates). Nga ketu konkludojmë se z.Ismet Loshi ka vënë nenshkrimin edhe në cilësinë e punëdhesit Drejtorit edhe në cilësinë e punëmarrësit gjë që e të njejtën kohë nuk mund të jetë edhe Drejtor i kompanisë dhe Inxhinier i angaxhuar ne Kompani e aq më pak ne cilësinë e menaxherit te projektit si përsoni kryesor ne mbarëvajtjen dhe udhëheqjen e një projekti. Kjo eshte ne kundershtim me Ligjin ne fuqi dhe fuqine per te vepruar. Madje edhe me vet aktin e themelimit

te kesaj kompanie.

- Gjithashtu ka te prezentuar te nenshkruar dhe vulosur nje Organogram te dates 03.08.2016, ne te cilen shkruan 2. I GRAFIKU I ORGANOGRAMIT (Ketu me poshte paraqesim formen e organizimit te kompanise "GRANIT", ku tregohen pozitat kryesore te personave kyq) qe z.Ismet Loshi Shifët qartë se është Drejtor i kompanisë edhe ne kete procedure te prokurimit dhe nuk e ka plotësuar kërkesen 9. 1 dhe 9.2 te FDT-së. Ku i mungojnë. Vendimi per mengjarin e projektit, kontrata e punës dhe Referneca per punët e kryera.

- **Udhëheqësi i punishtës,**

Operatori Ekonomik " Granit"- Istog, i shpallur fitues ka të prezentuar në ofertën e tij z.Mustaf Ademaj si inxhinier të ndertimtarisë, diplomën e noterizuar me numer 12, mirëpo nuk ka prezentuar Vendimin e Caktimit të udhëheqësit të punishtës, nuk ka prezantuar CV-inë dhe Referencat per punet e kryera në lëminë perkatese siç eshte kerkuar ne FDT pika 9. 1 dhe 9.2. Ku nuk e plotëson as kete kërkesë te "Dosjes së tenderit" dhe të "Njoftimit për kontratë". Prandaj nga OSHP-ja kerkojme qe edhe per kete pike e shte i papergjegjshem, kerkojme mbrojtjen ligjore nga OSHP, si organ meritor, qe ta restauroj te drejten tone dhe ta mbroje buxhetin ne dobi te thesarit te shtetit, duke parandaluar kompanite e papergjegjshme ligjore te perfitojne ne emer te shtetit me dokumentacion te dyshuar dhe falsifikuar.

- **Gjeodeti.**

Operatori Ekonomik "Granit sh.p.k" - Istog, i shpallur fitues ka të prezentuar në ofertën e tij z.Halit Kabashi si inxhinier i Gjeodezisë, diplomën e noterizuar me numer 68/83, mirëpo nuk ka prezantuar CVinë dhe Referencat per punet e kryera në lëminë përkatese siq është kërkuar në FDT pika 9. 1 dhe 9.2. Ku nuk e plotëson as këtë kërkesë të "Dosjes se tenderit" dhe të "Njoftimit për kontratë". Prandaj lusim OSHP-ne dhe ekspertin shqyrtues qe ta shqyrtoje me vigjilence edhe kete pike, sepse e njejta nuk ploteson FDT-ne.

- **Inxhinieri i Komunikacionit.**

Operatori Ekonomik i shpallur fitues ka të prezentuar në ofertën e tij z. Veton Gashi si inxhinier të komunikacionit, diplomën e noterizuar me numer 429, por nuk ka prezentuar CV-i në dhe Referencat per punet e kryera në lëminë perkatese siq eshte kerkuar ne FDT pika 9. 1 dhe 9.2. OE Graniti shpk ka te prezntuar nje kontratë ndermjet palëve për këtë projekt me datë 01.08.2016, mirëpo ka edhe një CV e cila do te duhej te dorezohej nga inxhinieri Veton Gashi dhe Jo nga Kompania të cilën e ka nënshkruar dhe vulosur OE Graniti shpk për projekte të realizuara nga në të kaluaren nga kompania e tij, ku nga Dokumentacioni i prezentuar (kontrata ndermjet paleve per angazhim ne kete projekt) ky inxhinier nuk ka qenë pjesë e projeketeve siq i ka përshkruar OE Graniti sh.p.k, me kete CV te pershtatur per nevojat ekompanise i ka qitur ne Lajthitje Autoritetin Kontraktues. Operatori Ekonomik Graniti shpk duke u bazuar ne faktet e lartepermenduara ku i mungojne CV-ja dhe Leter referenca nuk e plotëson as kete kërkesë te "Dosjes së tenderit" dhe të "Njoftimit për kontratë". Prandaj lusim OSHP-ne qe si organ meritor dhe me kompetence ne fushen e Prokurimit Publik qe ta ndeshkoje kete akt te qarte te falsifikimit duke i ndermarr te gjitha masat ligjore dhe te shqiptoj gjoben adekuate sipas dispozitave ligjore te LPP-se.

- **Inxhinieri i Elektros**

Operatori Ekonomik i shpallur fitues ka të prezentuar në ofertën e tij z.Skender Rugova si inxhinier të Elektros, diplomën e noterizuar me numer 612, nuk ka prezentuar CV-inë dhe Referencat per punet e kryera në lëminë perkatese siq eshte kerkuar ne FDT pika 9. 1 dhe 9.2. OE Graniti shpk ka te prezntuar nje kontratë ndermjet palëve për këtë projekt me datë 01.08.2016, mirëpo ka edhe një CV e cila do te duhej te dorezohej nga Inxhinieri Skender Rugova dhe Jo nga Kompania të cilën e ka nënshkruar dhe vulosur OE Graniti shpk për projekte të realizuara nga në të kaluaren nga kompania e tij, ku nga

Dokumentacioni i prezentuar (kontrata ndermjet paleve per angazhim ne kete projekt) ky inxhinier nuk ka qenë pjesë e projeketeve siq i ka përshkruar OE Graniti sh.p.k, me kete CV te pershtatur per nevojat ekompanise i ka qitur ne Lajthitje Autoritetin Kontraktues. Inxhinieri ne fjalë është i punësuar mbi 10 (dhjetë) vite si punëtor i rregullë ne Post-Telekomin e Kosovës, përkatësisht ne Selinë Qendore në Prishtinë dhe asnjehere më parë nuk ka qenë pjesë e kompanisë Graniti shpk siq e ka përshkruar OE ne CV-inë e tij. Projektet te cilat janë përshkruar ne CV-inë e manipuluar nga OE Grani sh.p.k per Inxhinierin e Elektros janë projekte nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Istogut dhe janë projekte (mund t'i kontrolloni në KRPP – Arhiva) në cilat nuk është kërkuar fare Inxhinier i elektros. Duke u bazuar në faktet e lartëpërmenduara ku i mungojne CV-ja dhe Leterreferenca nuk e plotëson as këtë kërkesë te "Dosjes së tenderit" dhe të "Njoftimit për kontratë".

PS: tani kemi kuptuar se inxhinieri i elektros Skender Rugova kur ka kuptuar se pronari i operatorit ekonomik "Granit"- Istog ka paraqitur ne formen e tij bizare kunderligjore deklarime te rreme ne lidhje me skender Rugoven, ky i fundit ka reaguar ne Ministrine, e Infrastruktures per falsifikim te CV-se dhe projekteve te prezantuara ne te duke deklaruar se informatat e rreme Ismet Loshi, pronari i kompanise i ka bere me qellim te perfitimit te tenderit, dhe se ato projekte nuk korrespondojne me te vertetat e inxh. Skender Rugova. Madje i njejti ka deklaruar se eshte ne marredhenie pune ne Organ Publik " Posta e Kosoves" dhe se ai asnjehere nuk pajtohet me falsifikimin qe i ka bere CV-se Pronari i Kompanis "Granit Istog.

- **PROVE SHKRESORE I REAGIMI I DATES 11.01.2017 I DOREZUAR NE MI. ADRESUAR BESIM TAHIRIT SHEFI I PROKURIMIT U.D DHE SEKRETARIT TE PERGJITHSHEM NE FORMEN E DEKLARATES**
- **Mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike që janë të domosdoshme për realizimin e projektit.**

Operatori Ekonomik "Granit sh.p.k" - Istog, i shpallur fitues nuk e ka të prezentuar siq është kërkuar ne FDTper kete pike:

Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacitetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), E noterizuar nga Noteri ose Origjinal. Operatori Ekonomik i shpallur fitues nuk i ka të Noterizuara Liçensen e Bazës së asfaltit, Liçensen e Gurëthyesit dhe Liçensën e bazës së Betonit. Të gjitha këto pasije apo stabilimiente për realizimin e projektit. Prandaj lusim OSHP-ne, qe ne perputhje me obligimet dhe autorizimet ligjore ta ndaloje kete shkelje te LPP-se.

- **Planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar**

Operatori Ekonomik i shpallur fitues ka të prezentuar në ofertën e tij nje Propozim/Plan te Menaxhimit te trafikut në një faqe i cili ma shumë i përngjan një deklarate dhe një deshire se çfarë pune do të realizohej dhe aspak një Plani të Menaxhimit të detajuar të Trafikut siq do të duhej të ishte dhe siq kërkohet në "Dosjen e tenderit" dhe në "Njoftimin për kontratë", plan i cili do të duhej të përmbante skena të rrugës, shënja të komunikacionit, projekt të menaxhimit të trafikut te automjeteve që do të qarkullojnë gjatë punës, etj. E tere kjo pasi qe keto norma jane obligative ne baze te Ligjit te Konventes se Vjenes, dhe se operatoret ekonomik bartin pergjegjesi ne Rruge edhe gjate punimeve, duke marre ne O Planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar - Operatori Ekonomik i shpallur fitues ka të prezentuar në ofertën e tij nje Propozim/Plan te Menaxhimit te trafikut në një faqe i cili ma shumë i përngjan një deklarate dhe një deshire se çfarë pune do të realizohej dhe aspak një Plani të Menaxhimit të detajuar të Trafikut siq do të duhej të ishte dhe siq kërkohet në "Dosjen e tenderit" dhe në "Njoftimin për kontratë", plan i cili do të duhej të përmbante skena të rrugës, shënja të komunikacionit, projekt të menaxhimit të trafikut te automjeteve që do të qarkullojnë gjatë punës, etj. E tere kjo pasi qe keto norma

jane obligative ne baze te Ligjit te Konventes se Vjenes, dhe se operatoret ekonomik *bartin pergjegjesi ne Rruge edhe gjate punimeve, duke marre ne konsiderate jeten e njerezve.*

- **Plani dinamik i detalizuar (gantogrami sipas pozicioneve të paramasës).**

Operatori Ekonomik " Granit"-Istog, i shpallur fitues ka të prezentuar në ofertën e tij një dokument disa fletësh në formatin MS Excell dhe jo në Formatin e kerkuar "Gantogrami sipas pozicioneve te paramasës". Jemi te bindur se as ai vet nuk e di se çka ka dashur të thote dhe te prezentoj me ate dokument te prezntuar si Plan Dinamik i cili edhe vet e konfirmon ne fleten e fundit te nenshkruar dhe vulosur se (Plani Dinamik do ti dorezohet menagjert te projektit per miratim sipas kontratës), ku vet e deshmon se nuk ka ofruar Plan Dinamik dhe nuk e plotëson as këtë kërkesë te "Dosjes së tenderit" dhe të "Njoftimit për kontratë". Eshte qudi se si AK i MI-se nuk e ka evidentuar kete fakt. Madje ne FDT MI-ja fare qarte e thekson se kerkohet nje plan dinamik i detajuar.

Ndërsa ne, LIKA TRADE sh.p.k jemi eleminuar plotësisht pa bazë, duke marre parasysh faktin se AK - MI, fare nuk ka respektuar dispozitat e LPP-se gjate prezantimit ne seancine e OSHP-se, ku rrjedhimisht si nga ju (OSHP), si nga Autoriteti kontraktues pas vendimit të OSHP-së, gjithashtu edhe nga paneli shqyrtues i OSHP-se ne vlerësimin e kritereve te prezentuara ne Ofertën tonë per kete procedurë të prokurimit, nuk e ka konstatuar sakte gjendjen e dokumentacionit. Tere kete per fajin e perfaqesimit jo profesional nga ana e MI-se ne mbrojtje te vendimit paraprak ku ne Lika Trade jemi shpallur fitues me merite dhe oferte me te lire per 30 mije euro.

Ne, Lika Trade sh.p.k reagojme fuqishem, pasi jemi eleminuar për pikat e poshtëshenuara për të cilat do t'iu sqarojmë me fakte se jemi eleminuar padrejtësisht.

Në bazë të nenit 17 të Rregullorës për Prokurim Publik:

I. Autoriteti kontraktues konsiderohet se ka respektuar vendimin e OSHP-se nese ka bere nje proces Ri-vleresimi (kur vendimi i OSHP-se e ka kerkuar kete) duke marre per baze vendimin e OSHP-se lidhur me pretendimet e bera ne ankese. 2. Autoriteti kontrakutes duhet te respektoj vendimin e OSHP-se per pretendimet e bera dhe varesisht nga ndikimi te marre nje vendim te Ri-vleresimit i cili nuk nenkupton me doemos ndryshimin ne rezultatin fillestar. Gjate procesit te Ri-vleresimit nje ndryshim ne rezultatin filestar mund te ndodhe duke marre per baze shqyrtimin e pretendimeve ne vendimin e OSHP-se nga i cili dalin fake apo prova te reja per te cilat AK-ja nuk ka qenë ne dijeni gjate procesit te vleresimit fillestar dhe/ose nje dispozite e ketij Ligji kerkon Anulimin e ketij Aktiviteti te Prokurimit. Madje ne oferte i kemi te gjitha dokumentet dhe shkresat qe deshmojne se ne i plotesojme te gjitha pikat e FDT-se, por anashkalimit i mbrojtjes se interesit tone ka ardhur si rezultat i mosperfaqesimit te drejte nga ana e M1-se, ne rastin e mbrojtjes se vendimit per dhenie te kontrtes per " Lika Trade sh.p.k"-Deçan. Ky fakt na shqeteson pa mase, kur vihet re se jemi te pergjegjshem dhe jemi me te lire per afer 30 mije euro. Prandaj kerkojme nga OSHP-ja qe ta mbroje buxhetin shteteror te Kosoves, edhe ashtu te varfur, ne dobi te αvíeíαrií.

Ne, Lika Trade shpk në bazë të "Letrës Standarde për elemimin' jemi eleminuar komplet pa të drejtë për arsyet e poshtëshenuara:

1. Kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të çertifikuara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2013.2014 dhe 2015) (të bashkëngjitet kopja e noterizuar e licencës së Auditimit). Lika Trade sh.p.k ka respekuar Ligjin Nr.04/L-014 PËR KONTABILITET RAPORTE FINANCIARE DHE AUDITIM Ne bazë të këtij ligjit perkatesisht nenit Neni 4 mbi Klasifikimin e Shoqërive Tregtare ne i takojme kategorise se kompanive te mesme

- **Kompani e mesme janë keto kompani si ne vijim:**

"Neni 4 mbi Klasifikimin e Shoqërive Tregtare 1.2. shoqëritë tregtare të mesme janë ato të cilat

plotësojnë dy nga ti kriteret në vijim: 1.2.1. qarkullim vjetor (neto): më i madh se dy milion (2,000,000) mirëpo më i vogël se katër milion (4.000.000) Euro. 1.2.2. asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: në mbi një milion (1.000.000) dhe me pak se dy milion (2,000,000) Euro;

Ndërsa obligim për auditim përcaktohet me këtë nen:

5. Pasqyrat financiare sipas nën-paragrafit nenit 4 paragrafi 1. nën-paragrafët 1.2 të këtij ligji do të auditohen nga fimat e auditimit ose auditor që janë të licencuar për të kryer auditime nga autoritetet kompetente siç janë definuar në këtë ligj.

Lika Trade shpk ka dorëzuar Raprotin e Auditorit dhe Pasqyrat e Audituara Financiare nga Auditori i Liçensuar konform Ligjit të Miratuar në Kuvendin e Republikës së Kosovës duke ia bashkangjitur Liçensen përkatëse të Noterizuar te Auditorit. Më poshtë po ju prezentojmë vlerat e qarkullimit për secilin nga vitet e kërkuara. Qarkullimi per vitin 2013 ka qenë 3,388,330 €. Qarkullimi per vitin 2014 ka qenë 3,497, 21 1 € Qarkullimi per vitin 2015 ka qenë 3,911,576 €.

Nga kjo shifet se ne i kemi bërë Auditimin e pasqyrave Financiare konform Ligjit. Ku kërkojmë fuqishëm nga ju si si Organ Shqyrtues i prokurimit ia mbroni Ligjin e Republikes se Kosoves ne dobi te shtimit te buxhetit dhe jo demtimit te tij, si ne rastin e veprimit nga ana e Autoritet kontraktues, që duke mos respektuar Ligjin Nr.04/L014 i Republikës së Kosovës, ne diskriminohemi në mënyrë Joligjore, dhe buxheti demtohet per afër 30 mije euro, duke perzgjedhur nje kompani (Granit sh.p.k) qe ka ofruar dokumentacion te pavertete dhe te falsifikuar, tanime i argumentuar nga vet stafi kyç i kesaj kompanie.

Gjthashtu ne ofrojme te dhena ne kete ankese edhe per

2. "Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Dëshmia 1-5

Kopjet e diplomave përkatëse, CV. Kontratat e punës me ofertuesin të noterizuara, dhe referencat për stafin që do të jetë i angazhuar për këtë projekt. Për gjeodetin (kërkesa 3) duhet të ofrohet kopja e licencës e noterizuar.

LIKA TRADE sh.p.k, si operator i përgjegjeshëm me çmimin me të ultë ka përbushur në përpikmëri të gjitha kriteret e "Dosjes se Tenderit" dhe te "Njoftimit për kontrat" e gjithashtu edhe këtë kriter, ku për stafin e angazhuar për këtë projekt ka dorezuar ne ofertë Diplomen e Noterizuar, CV-in, Kontratën e punës për angazhim në kete projekt te Noterizuar dhe LeterReferencen. (kërkesa 3) Liçensa e Gjeodetit e Noterizuar. Kurse për Menaxherin e projektit dhe udhëheqësin e punishtes ka dorëzuar Diplomen e Noterizuar, CV-in, Leter-Referencen dhe Kontraten e punës Origjinal si punëtor te rregullt te kompanisë, gjithashtu mund te shifen edhe në Listen e pagave ne Origjinal si punëtor shumë vjeqar te kompanise. **Origjanli është dokumenti bazë nga i cili bëhet Noterizimi i një dokumenti.**

LIKA TRADE sh.p.k, si operator i përgjegjeshëm me qmimin me të ultë ka prezentuar në ofertë një Listë të projekteve me mbi 40 projekte së bashku me kontrata, refenca dhe procesverbale te pranimeve teknike ne tri vitet e fundit. Ku janë të përfshira Rrugët Nacionale, Regjionale, Asfalltim të shtresave qarkulluese, Rehabilitim te rrugëve Nacionale dhe Regjionale, mirëbajtje te tyre. Projekte që deshmojnë përvojen shume here me te madhe se sa Operatori Ekonimik i shpallur fitues dhe me çmimin më të shtrejt. Ku per permbushjen e kushteve ne lidhje me rrugen nacionale dhe regjionale do ta deshmojme edhe para panelit shqyrtues te OSHP-së se kemi mjaftë kontrata dhe projekte përkatëse.LIKA TRADE sh.p.k, si operator i përgjegjeshëm me qmimin me të ultë ka prezentuar në ofertë një Listë të paisjve siq eshte kerkuar ne FDT-në e noterizuar nga Noteri i cili deklaron se Kompania Lika Trade sh.p.k i posedon në pronësi të gjitha paisjet e kërkuara dhe të prezentuara. Gjithashtu i ka te prezentuar te Noterizuara Liçensën e Bazës se Asfaltit, Liçensen e Gurëthyesit si dhe Liçensen e bazës së Betonit. Të gjitha këto pasije apo stabilimiente për realizimin e projektit. Kerkojme nga OSHP, si organ i themeluar

me qellim te mbrojtjes se ligjshmerise dhe buxhetit te Republikes se Kosoves, ne perputhje te plote me Nenin 1 te LPP-se, qe ti ndaloni keto keqperdorime, te deshmuara me prova ne kete rast, dhe ta mbroni buxhetin ne kete rast ne vleren prej afer 30 mije euro.Kerkojme nga Organi Shqyrtues i Prokurimit, që duke vepruar në pajtim me autoritetin qe ka ligjor, ta anuloj njoftimin për dhënie te kontrates per kompanine "Granit sh.p.k"-Istog, dhe aktivitetin ta kthej në RTVLERËSIM, ku, detyrohet Autoriteti Kontraktues qe te respektoj dispozitat ligjore dhe dosjen e tenderit. Dhe se shqiptohet gjoba ligojre ndaj Operatorit Ekonomik "Granit sh.p.k" per ofrimin e te dhenave te rreme dhe mashtrimit ne kete procedure, sipas LPP-se. Si ankues OE "Lika Trade sh.p.k" marre ne konsiderate te gjitha shkeljet e evidentuara i rezervojme te gjitha te drejtat tona ligjore qe te mbahemi te informuar ne te gjitha fazat e ketij procesi.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit në KRPP-së për kontratë (N.35) :.....24.06.2016
Lloji i procedurës së aplikuar (N.32-35):-.....Procedur e hapur
Lloji i kontratës së publikuar(N.16): .....Furnizim/vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 03.08.2016

Data e hapjes së ofertave (N.58):.....03.08.2016-ora 14;30h
Data e njoftimit për dhënien e kontratës.....28.12.2016
Kriter për dhënien e kontratës.....Tenderi përgjegjshëm çmimi më i ulët

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi		Çmimi	Vërejtje
1	PEVLAKU SH.P.K	PRISHTINË-TIRANË		1.734.963.37€	JO
2	TRASING GROUP&EURO ASPAKT	GJAKOVË-DRENAS		1.441.939.15 €	JO
3	GRANITI SH.P.K	ISTOG		1.465.848.89 €	JO
4	CONEX GROUP&TIC	PRISHTINË		1.497.577.23€	JO
5	ASFALTI&ARFA	DEÇAN-PEJË		1.361.083.98€	JO
6	LIKA TRADE	DEÇAN		1.444.006.67€	JO
7	KAG ASPHALT	PRIZREN		1.499.884.10€	JO
8	RSM	PRISHTINË		1.487.412.91€	JO
9	VICTORIA INVEST INC	SUHAREKË		1.807.979.80€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë nëntë (9) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes nuk është rexhistruar asnjë vërejtje në lidhje me hapjen e ofertave.

Kriteret për kualifikim:

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:
1. Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 65.

2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, s operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.
3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat pershtatshmerise" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar.

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë:

- Një deklaratë nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën e përcaktuar ne dosjen e tenderit. – Origjinal.

Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise, **pika 2 dhe 3**, do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet.

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

1. Regjistrimi i OE në regjistrin profesional,komercial ose korporatës në vendin e themelimit e përkthyer në gj.shqipe,angleze ose serbe.(Ofertuesi jo rezident sipas Ligjit aktual të Kosovë LPP Nr 04/L-042) është i detyruar të paraqes çertifikatën e regjistrimit të njësisë përhershme-para nënshkrimit të kontratës.
2. Regjistrimi i TVSH;
3. Çertifikata për sistemin e Menaxhimit të Cilësisë ISO 9001:2008
4. Çertifikata për Sigurinë në Trafikun Rrugor ISO 39001: 2012

Dëshmitë dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit e noterizuar);
2. Kopja e TVSH-së e noterizuar:
3. Kopje e noterizuar e çertifikatës ISO 9001:2008
4. Kopje e noterizuar e çertifikatës ISO 39001:2012

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Raporti auditimit dhe i pasqyrave të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2013,2014 dhe 2015), ku kërkohet që qarkullimi i OE ose grupit të jetë jo më pak se 4,000,000.00 euro.
2. Kapital të mjaftueshëm për realizimin e kontratës (Mjete të gatshme në xhirollogari nga kompanija në bankë në vlerë prej së paku 300,000.00€, ose qasje te pakushezuar ne kredi).

Dëshmia – 1

Kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporteve të menaxhmentit të çertifikuara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2013,2014 dhe 2015) (të bashkëngjitet kopja e noterizuar e licencës së Auditimit).

Dëshmia – 2

Deklaratë të pakushtëzuar nga banka që dëshmon se OE ka mjete të gatshme në xhirollogari ose çasje në kredi, dokumenti të jetë origjinal i nënshkruar dhe vulosur nga institucioni bankar.

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Stafi teknik i kërkuar:

Menaxher i projektit

1. Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë me 3 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy(2) projekte nga lëmia e kërkuar (rikonstruktimi,ose ndërtimi i rrugëve).

Udhëheqësi i punishtes

2. Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë me 2 vite përvojë pune pas diplomimit,si udhëheqës i punishtes në projektet e ndërtimit, rehabilitimit, apo rikonstruktimit të rrugëve. Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.

Gjeodeti

3. Inxhinier i diplomuar i gjeodezisë me dy vite përvojë pune pas diplomimit. Gjeodet (shkolla e lartë), ose Bahcelor i diplomuar i gjodezisë me tri vite përvojë pune pas diplomimit. Minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e kërkuar.
4. Inxhinier i komunikacionit me 2 vite përvojë pune pas diplomimit, në lëmin e kërkuar.
5. Inxhinier i elektros me 2 vite përvojë pune pa diplomimit ose bachelor i diplomuar i elektros.
6. Listën e kontratave jo më pak se 2,000,000.00 €, të lëmisë së kërkuar në periudhën e shkuar trevjeçare (2013, 2014 dhe 2015) . Operatori ekonomik duhet të ketë minimum dy (2) projekte të realizuara në lëmin e ndërtimit të rrugëve nacionale ose regjionale.

"NDËRTIMI I RRETHRROTULLIMIT TË GJELBËR(BULEVARDI I GJELBËR) NË RRUGËN NACIONALE N9 (hyrja e Pejës)"

Nr.	Lloji i mekanizimit dhe pajisjeve	Sasia e kërkuar (cope)	Sasia që ofron ofertuesi	Të dhënat për pajisjet (viti I prodhimit ,gjendja e pajisjes , kamiona rexh. I targave,mekanizimi ,dëshmitë mbi pronësinë ose kontratë për huazim ,foto etj)
1.	Eskavator, kapac. 0.4 - 1 m^3	1		
2.	Eskavator, kapac. 3-4 m^3	3		
3.	Eskavator me çekan pneumatic	1		
4.	Kamion kapacitet 10 m^3 Kipper.	4		
5.	Ngarkues, kapac. 0.4 - 1 m^3	3		
6.	Ngarkues, kapac. 3-4 m^3	1		
7.	Cilindër 12 t,vibrues	2		
8.	Cilindër 12 t me dhëmbëza,vibrues	1		
9.	Grejder 12-16t	1		
10.	Autopompë betoni	1		
11.	Kamion për transport të betonit të gatshëm	2		
12.	Cisternë për karburante	1		
13.	Vibrator për beton	1		
14.	Paisjet për prerjen dhe lakimin e armatures	1		
	Pajisjet e nevojshme për punët e asfaltit			
15.	Finisheri për shtrirjen e asfaltit	1		
16.	Cilindrat me rrota të kombinuara(gomë dhe hekur) 7-8 t	1		
17.	Cilindrat me rrota hekuri me vibrim 12t	1		
18.	Cilindër me rrota hekuri me vibrim 3 t	1		
19.	Cisternë (tanket) e ujit	1		
20.	Spërkatës për bitumen dhe emulsion	1		
21.	Kamion për transport të asfaltit të gatshëm	4		

mesatarisht 50 të punësuar.
9 . Bazë për prodhimin e asfaltit e licencuar, në pronësi, apo marrëveshje për furnizim me asfalt.
10. Gurëthyes i licencuar në pronësi apo marrëveshje për furnizim me zhavorr (agregat).
11. Bazë për beton nga një kompani e licensuar ose marrëveshje për furnizim.
12. Planin për menaxhimin e trafikut sa më të detajuar.
13. Plani dinamik i detalizuar (gantogrami sipas pozicioneve të paramasës).
14. OE duhet të na siguroj se të njejtin staf teknik dhe profesional nuk e ka të angazhuar edhe në projekte tjera, të cilat janë në realizim nga MI-ja, në më pak se 50% të vlerës së punëve.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:
Dëshmia 1-5
Kopjet e diplomave përkatëse, CV, Kontratat e punës me ofertuesin të noterizuara, dhe referencat për stafin që do të jetë i angazhuar për këtë projekt. Për gjeodetin (kërkesa 3) duhet të ofrohet kopja e licencës e noterizuar.
Dëshmia 6
Të paraqiten dëshmitë:referenca ose procesverbalet e pranimit përfundimtar të punëve duke treguar vlerën, datën, natyrën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve në lëmin e kërkuar, ne tri vitet fundit (2013, 2014 dhe 2015) .
Dëshmia 7
Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacitetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas specifikimit teknik në dosjen e tenderit), E noterizuar nga Noteri ose Origjinal.OE duhet të sjell dëshmi (specifikimin për pajisjen)për pajisjet, të cilat ka ndërmend t'i angazhoj për këtë projekt (pajisjet duhet të verifikohen nga noteri sipas procedurës se verifikimit të pajisjeve).
Dëshmia 8
Listën e pagave të operatorit ekonomik. Duhet të dorëzohet origjinali ose kopje e noterizuar.
9-10-11
Licenca e vlefshme e lëshuar nga Agjencioni për Miniera dhe Minerale.
Deshmia 12.
Origjinali i planit të menaxhimit të trafikut i nënshkruar dhe vulosur nga kompania.
Dëshmia 13.
Plani dinamik origjinal i nënshkruar dhe vulosur.
Dëshmia 14
OE duhet të ofrojë një deklaratë me shkrim nën betim të nënshkruar dhe vulosur, me të cilën siguron se të njejtin staf teknik dhe profesional nuk e ka të angazhuar edhe në projekte tjera, të cilat janë në realizim e sipër nga MI-ja, në gjendjen më pak se 50% të vlerës së punëve.

Komisioni vlerësimit pran AK-së:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N.80).

Afrim KAMBERI: Kryesues,
Gëzim OSMANI: Anëtar,
Emine KRASNIQI; Anëtar,

Komisioni vlerësues ka përfunduar punën (raportin e vlerësimit), me datë 19.12.2016

Raporti i komisionit vlerësues:

Në bazë të kritereve të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe dokumentacionin tenderues, komisioni për ri-vlerësimin e ofertave i emëruar me vendimin e datës 20.11.2016, me nr. Protok.6126, i cili filloi punen me datë 06.12.2016, pas procesit të vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve konstatoi se nga 9 operator ekonomikë të cilët kanë ofertuar për projektin: "Ndërtimi i rreth-rrotullimit të gjelbër (Bulevardi i Gjelbër) në rrugen nacionale N9 (Hyrja e Pejës), 6 (gjashtë) OE plotësuan kriteret e kërkuara të përzgjedhjes të caktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit, ndërsa vetëm 3 OE ishin të pa-përgjegjshëm pasi që nuk i plotësuan kriteret e kërkuar të përzgjedhjes të caktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.
Keriter për dhënie të kontratës është "Tenderi pëgjegjshëm me çmim më të ulët".

Në bazë të LPP-së, si dhe kritereve të FDT, komisioni për vlerësimin e ofertave në mënyrë unanime rekomandon për kontrat OE GRANITI – Istog.

Përgjigjje në pretendimet ankimore nga Ekspertit shqyrtues: (N. 113.1), konform njoftimit të OSHP-së të datës 19.11.2014, nr.prot.848/14:

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të lëndës së tenderit për këtë aktivitet të prokurimit, bazuar në dokumentacionin që kanë pasur në dispozicion eksperti shqyrtues jep mendimin si në vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron:
Autoriteti kontraktues gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, kontrat për furnizim, vlerë e madhe, e ndarë në lote, kriter për dhënie të kontratës ka qenë: "Tenderi i përgjegjshëm çmimi më i ulët".

I pakënaqur me njoftimin për dhënien e kontratës të datës 28.12.2016, për këtë aktivitet të prokurimit, operatori ekonomik: "LIKA TRADE"sh.p.k & "CONEX GROUP"shpk, fillimisht kanë parashtruar ankesë në Autoritet kontraktues, dhe pastaj duke parashtruar ankesë edhe në OSHP me datë 18 dhe 19 Janar 2017, me pretendim ankimor se nuk është respektuar:

OE ankues "Conex Group" sh.p.k:
Neni 1.36 i LPP-së, (Tenderet e pa përgjegjshëm),
Neni 59 i LPP-së, (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve),
Neni 60 i LPP-së, (Kriteri për dhënien e kontratës, par.1.1),

OE ankues "Lika Trade"sh.p.k:
Neni 1 i LPP-së, (Qëllimi),
Neni 7 i LPP-së, (Barazia në trajtim/Jo Diskriminimi),

Neni 10 i LPP-së (Mjetet për promovimin e transparencës),
Neni 27 i LPP-së (Dosja e tenderit),
Neni 52 i LPP-së (Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës),
Neni 56 i LPP-së, (Dispozitat e përgjithshme mbi përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave)
Neni 59 i LPP-së, (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve),
Neni 60 i LPP-së, (Kriteri për dhënien e kontratës),
Neni 65 i LPP-së, (Pranueshmëria e kandidatëve ose tenderuesve),
Neni 69 i LPP-së, (Aftësia teknike dhe/ose profesionale),
Neni 72 i LPP-së, (Dokumentacioni dhe informacioni shtesë),
Neni 108/A i LPP0-së, (Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve),

Ne interpretim të asaj që u tha më lartë, po sqarojmë se i kemi shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndes, konkretisht ato që lidhen me zbatim të vendimit të lartë përmendur (pretendimeve ankimore) dhe atë si në vijim:

Pretendimi ankimor nr.1- OE CONEX GROUP&LIKA TRADE,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket çertifikates së biznesit të OE "GRANITI" të rekomanduar për kontrat,

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pjesërisht ky pretendim ankimor, për faktin se në dosjen e tenderit është kërkuar certifikata e biznesit, OE GRANITI, në dosjen e ofertës origjinal ka ofruar çertifikaten e biznesit vetëm fletën e parë të saj por jo komplet çertifikaten me informatat e biznesit siç duhet të ishte, por si e tillë është pranuar si mjaftueshme nga ana e Autoritetit kontraktues, mendoj se AK-ja është dashur të kërkoj plotësimin e këtij dokumenti në harmoni me nenin 72 të LPP-së, pasi që si dokument ka ekzistuar në dosjen e OE, por i pakompletuar.

Konstatimi i lartë cekur nr.1, vlen edhe për OE ankues LIKA TRADE , pasi që i njëjti ka pretendim ankimor të njejtë në lidhje me çertifikaten e biznesit të OE GRANITI.

Pretendimi ankimor nr.2- OE CONEX GROUP&LIKA TRADE,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket noterizimit në gjuhen angleze për dokumentet:
Certifikata e TVSH-së,
Certifikata për sistemin e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2008,
Certifikata për sigurinë në Trafikun Rrugor ISO 39001:2012,

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron ky pretendim ankimor, për faktin se noterizimi i dokumenteve është i rregulluar me ligjin mbi noterinë LIGJI Nr. 03/L-010, dhe çdo dokument i noterizuar bëhet duke u bazuar në dokumentin origjinal, në rastin konkret NUK ka qenë e nevojshme të bëhet përkthimi në gjuhen shqipe ashtu siç pretendon OE ankues
Konstatimi i lartë cekur nr.2, vlen edhe për OE ankues LIKA TRADE , pasi që i njëjti ka pretendim ankimor të njejtë në lidhje me çertifikaten e noterizuar të OE GRANITI.

Pretendimi ankimor nr.3- OE CONEX GROUP & LIKA TRADE,
Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket pasqyrave të auditorit të OE "GRANITI" të rekomanduar për kontrat,

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pjesërisht ky pretendim ankimor, për faktin se në dosjen e tenderit është kërkuar *Raporti auditimit dhe i pasqyrave të audituara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion për vitet (2013,2014 dhe 2015), ku kërkohet që qarkullimi i OE ose grupit të jetë jo më pak se 4,000,000.00 euro*, OE GRANITI, në dosjen e ofertës origjinal ka ofruar pasqyrat e auditorit për vitet 2013,2014 dhe 2015 të cilat siç janë të paraqitura mbulojnë shume e qarkullimit jo më pak 4,000,000.00€, andaj gjatë ekzaminimit të pasqyrave financiare konstatojmë se pasqyrat financiare për vitin 2013 dhe 2015 janë të pa nënshkruar nga drejtori gjeneral dhe drejtori financiar siç kërkohet të vendoset nënshkrimi i këtyre drejtorave dhe si të tilla kanë sjellur dyshime të bazuar për OE-të ankues, por të njejtat janë pranuar si të mjaftueshme nga ana e Autoritetit kontraktues, Eksperti shqyrtues mendon se AK-ja është dashur të kërkoj plotësimin e këtij dokumenti në harmoni me nenin 72 të LPP-së, pasi që si dokument ka ekzistuar në dosjen e OE, por i pakompletuar.

Konstatimi i lartë cekur nr.3, vlen edhe për OE ankues LIKA TRADE , pasi që i njëjti ka pretendim ankimor të njejtë në lidhje me çertifikaten e noterizuar të OE GRANITI.

Pretendimi ankimor nr.4- OE CONEX GROUP & LIKA TRADE,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket inxhiniereve të ofruar nga OE "GRANITI" i rekomanduar për kontrat, konkretisht inxhinierit të elektroteknikes,

Eksperti shqyrtues vlerëson se qëndron pretendimi ankimor në lidhje me inxhinierin Skender Rugova duke u bazuar në dokumentacionin dhe shkresat e lendes, ku me datë 11.01.2017, inxhi. Skender Rugova ka deponuar deklarat me shkrim mr.nr.protokoli 04/103 të dt.11.01.2017, në Ministris Infrastruktures ku deklaron: "*se Cv-ja tij e përdorur nga Kompania GRANITI sh.p.k – Istog, për plotësimin e dokumentacionit për ofertim në këtë projekt: Ndërtimi i rreth-rrotullimit të gjelbër (Bulevardi i Gjelbër) në Rrugën Nacionale N9 (hyrja e Pejës)", me nr. prokurimi:MI 16/082/511, NUK është e imja dhe nuk ka të bëjë me përvojen dhe të kaluaren time dhe e njëjta në kushte normale ligjore nuk do të duhej të përdorur,. Për projektet e paraqitura në atë cv të prezantuar në muajin Gusht 2016, NUK kam qenë asnjëher pjesë e ekzekutimit të tyre e as që kam dëgjuar për to".*

Eksperti shqyrtues duke u bazuar në këtë deklarat me shkrim nga ana e inxhi. Skender Rugova vlerësoj se OE i rekomanduar për kontrat ka bërë shkelje të rëndë në kundeshtim me deklaraten nën betim, për faktin se i njëjti ka falsifikuar dokumentin e inxh, në fjalë.

Ndërsa sa i përket inxhiniereve tjerë të ofruar nga OE Graniti sh.p.k, për këtë projekt, Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja në harmoni me nenin 72 të LPP-së mundë të verifikoj referencat e ofruar për këto inxhinier se të njëjtat a janë në përputhje me përshkrimin e bërë në cv, nga OE ana e OE të rekomanduar për kontrat.

Pretendimi ankimor nr.5- OE CONEX GROUP & LIKA TRADE,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket *planit për menaxhimin e trafikut dhe planin dinamik* të ofruar nga OE "GRANITI" i rekomanduar për kontrat,

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor për faktin se kjo kërkes është plotësuar nga ana e OE i rekomanduar për kontrat, të njëjtat janë pranuar si të mjaftueshme nga ana e komisionit vlerësues profesional pranë AK-së.

Pretendimi ankimor nr.6- OE LIKA TRADE,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket *menaxherit të kompanis se i njëjti ka bërë nënshkrimi e dokumenteve në cilësin e punëdhënësit dhe punëmarrësit,*

Eksperti shqyrtues vlerëson se kjo qështje NUK është e rregulluar me Ligjin e prokurimit publik dhe nuk mundem të japë një vlerësim në lidhje me këtë.

Pretendimi ankimor nr.7- OE LIKA TRADE,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket *licencën e bazës së asfaltit, gurthyesit dhe bazës së asfaltit NUK janë të noterizuar,*

Eksperti shqyrtues vlerëson se NUK qëndron pretendimi ankimor në lidhje me këtë, për faktin se kjo kërkes në FDT-të faqe 21 dëshmia nr.9-10-11 në lidhje me këto licenca NUK është kërkuar të jenë të noterizuar.

Pretendimi ankimor nr.8- OE LIKA TRADE,

Në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket *arsyes të eliminimit nga ana e AK-së, si dhe vendimit të OSHP-së nr.335-337/16 i dt.27 Tetor 2016,*

Eksperti shqyrtues s'qaron se në lidhje me këto pretendime ankimor njoftoj panelin shqyrtues se të njëjtat pretendime janë shqyrtues paraprakisht me vendimin nr.335-337/16, ndërsa i përket pretendimit ankimor në lidhje me nenin 17 te Rregullores për prokurim publik, Eksperti shqyrtues vlerëson se AK-ja gjatë ri-vlerësimit duhet të ketë parasysh paragrafin 2 të nenit 17 të Rregullores për prokurim publik.

Eksperti shqyrtues vlerëson në lidhje me pretendimin ankimor sa i përket kërkes për ri-shqyrtim të vendimit të AK-së në lidhje me nenin 108/A, qëndron pretendimi ankimor duke u bazuar në atë se Autoriteti kontraktues NUK ka bërë shqyrtimin e gjithë pretendimeve ankimore, në harmoni me dispoziten e ligjit 108/A, paragrafi 12, Ligji Nr. 04/L-042, PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues:

Eksperti shqyrtues duke u mbështetur në vlerësimet e lartë cekura, i rekomandon panelit shqyrtues që të APROVOJ si pjesërisht të bazuara, ankesat e Operatorëve Ekonomik ankues: "Conex Group"sh.p.k & "Lika Trade"sh.p.k, për këtë aktivitet të prokurimit dhe njëherit të ANULOJ si të pa bazuar vendimin e Autoritetit kontraktues Njoftimi për dhënien e kontratës i datës 28.12.2016, dhe ky aktivitet i prokurimit: "Ndërtimi i rreth-rrotullimit të gjelbër (Bulevardi i Gjelbër) në Rrugën Nacionale N9 (hyrja e Pejës)", me nr. prokurimi:Mi 16/082/511 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Ministria e Infrastruktures, të kthehet në RI-VLERËSIM.